



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:123853

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06383043

**P.nr.152/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, në përbërje prej Gjyqtarës së vetme gjykuese Benita Berisha, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit G. L. nga fshati G. e U. K. Lipjan, të cilën e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.1217/24, të datës 26.04.2024, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 03.10.2024, në prani të prokurorit të shtetit Paulin Pashku, të pandehurit G. L. dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS, Q. S., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 31.10.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit:

**G. L.**, i lindur me datën *data e lindjes...*, në Lipjan, tani me vendbanim në fshatin G. e U.K.Lipjan, nga i ati R., e ëma R., i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer dy vite të shkollës së mesme tregti, pensionist i FSK-së, me numër personal-*numri...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**SEPSE:**

Prej datës së pacaktuar deri me datën 09.11.2023, nga ana e personave të autorizuar të të dëmtuarës KEDS, është konstatuar se i pandehuri G. L. në shtëpinë tij në fshatin G. të U. të Komunë së Lipjani, me qëllim të vjedhjes dhe keqpërdorimit të energjisë elektrike pa autorizimin e KEDS-it, që vetës t'i sjellë pasuri të kundërligjshme, derisa njëhori i elektrik me numër 32593779 që ka qenë duke e shfrytëzuar ka qenë i zhvendosur në shtyllë i shkyçur, ka vepruar në atë mënyrë që është këqyr direk të në rrjetin elektrik dhe është furnizuar me energji elektrike pa matje, me ç' rast të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm në vlerë 146.58.-€,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në baze të dispozitave të neneve, 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe nenit 314 par. 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 365, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së, i shqipton:

## DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit G. L., i përcakton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

**OBLIGOHET** i pandehuri, që të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, t'ia kompensoj shumën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 146.58.-€ ( njëqind e katërdhjetë e gjashtë euro e pesëdhjetë e tetë cent), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**OBLIGOHET** i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.-€ dhe shumën prej 20.-€ në Fondin e Viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.nr.1217/24, të datës 26.04.2024, e ka akuzuar, të pandehurin G. L., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 03.10.2024, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Paulin Pashku, i pandehuri G. L. dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS-Q. S..

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se, e pranon fajësinë sipas aktakuzës duke shtuar se, është penduar thellë për rastin që ka ndodhur, i ka kërkuar falje gjykatës dhe palës së dëmtuar, si i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen veprime të tilla nuk do të përsëriten nga ana e tij, si dhe ka lutur gjykatën që të i shqiptoj një dënim sa ma të butë pasi që e ka gjendjen tejet të rëndë ekonomike është pensioner dhe mbajtës i familjes 8 anëtarëshe.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që janë plotësuar kushtet nga neni 242 të KPP-së. Pranimi i fajësisë është vullnetar, i sinqertë dhe në mbështetje me të gjitha provat që i përmban aktakuza, i ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe i ka propozuar gjykatës që më rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit të merren parasysh të gjitha rrethanat e parapara me ligj ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar KEDS, në shqyrtimin fillestar me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, dhe shtoi se nuk kërkojë që të dënohet i pandehuri por parashtronë kërkesë pasuroro-juridike.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga e pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e

aprovoi pranimin e fajësisë të të pandehurit, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në matjen e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin vlerësoi keqardhjen e shprehur dhe pendimin e thellë për veprën e kryer, faktin se është baba 6 fëmijëve dhe mbajtës i familjes, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit më veprime të tilla, e rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar ndërsa, rrethana rënduese gjeti faktin se i njëjti ka qenë më parë i dënuar me aktgjykime të formës se prerë dhe atë P-84/2019, i plotfuqishëm me datë 10/04/2019, P-213/2021, i plotfuqishëm me datë 21/06/2021, P-525/2023, i plotfuqishëm me datë 24/01/2024 dhe P-64/2024, i plotfuqishëm me datë 12/08/2024.

Andaj, gjykata marrë parasysh rrethanat e lartcekura të njëjtit i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën par 3.1 të Ligjit numër 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore juridike u bazua në nenin 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTNË -DEGA NË LIPJAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.152/24, me datën 31.10.2024.**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Visar Zeqiri**

**GJYQTARJA**  
**Benita Berisha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.